

VENDIM
Nr. 686, datë 2.9.2020

PËR KRITERET E DHËNIES SË BURSIVE PËR SHTETASIT E HUAJ ME ORIGINË SHQIPTARE, PËR TË STUDIUAR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË, NGA AGJENCIA KOMBËTARE E DIASPORËS, PËR VITIN AKADEMIK 2020–2021

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të shkronjës “ë”, të nenit 5, të ligjit nr. 16/2018, “Për diasporën”, të ndryshuar; të nenit 11, të ligjit nr.115/2017, “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës”; si dhe në vijim të nenit 7, të vendimit nr. 504, datë 24.6.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të studentëve të cilët studiojnë jashtë vendit, dhe shtetasve të huaj me origjinë shqiptare, të cilët përfitojnë bursa nga Republika e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Diasporën, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien e 9 (nëntë) bursave për shtetasit e huaj me origjinë shqiptare, të cilët përfitojnë bursa studimi nga Republika e Shqipërisë, për vitin akademik 2020–2021.

2. Bursa e studimit për shtetasit e huaj me origjinë shqiptare përfshin mbulimin financiar për tarifën e studimeve, si dhe shpenzimet e akomodimit e të ushqimit për kohëzgjatjen e vitit akademik, në masën e përcaktuar në aneksin 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Për vitin akademik 2020–2021 do të akordohen 9 (nëntë) bursa për shtetasit e huaj me origjinë shqiptare, për të studiuar në Republikën e Shqipërisë, për vendet, si më poshtë vijon:

- a) 3 (tre) bursa studimi për shtetasit e huaj me origjinë shqiptare nga Ukraina;
- b) 2 (dy) bursa studimi për shtetasit e huaj me origjinë shqiptare të komunitetit arbëresh në Itali;
- c) 2 (dy) bursa studimi për shtetasit e huaj me origjinë shqiptare në Kroaci;
- ç) 2 (dy) bursa studimi për shtetasit e huaj me origjinë shqiptare nga Bullgaria.

4. Misionet diplomatike dhe postet konsullore të Republikës së Shqipërisë, të akredituara në vendet e përmendura në pikën 3, të këtij vendimi, bëjnë propozimet për kandidatët, për përfitimin e bursës për shtetasit e huaj me origjinë shqiptare, për vitin akademik 2020–2021. Ato janë përgjegjëse për dërgimin e dokumentacionit të kërkuar për kandidatët përfitues të bursës.

5. Dokumentacioni që do të paraqitet nga aplikantët duhet të jetë i legalizuar në përputhje me legjislacionin që rregullon njohjen dhe përdorimin e dokumenteve zyrtare të lëshuara jashtë vendit.

6. Kriteret bazë për përfitimin e bursës që duhet të plotësojë aplikanti janë, si më poshtë vijon:

- a) të ketë mbaruar arsimin e mesëm me një mesatare të përgjithshme mbi 8 (tetë) ose të barasvlershme me të;

- b) të mos jetë i diplomuar në ciklin e plotë të studimeve universitare;
- c) të jetë student nga komunitetet shqiptare të diasporës dhe që jeton në një nga vendet e lartpërmendura në pikën 3, të këtij vendimi.

7. Kriteret për përfitimin e bursave, sipas programeve ku do të studiojnë shtetasit e huaj me origjinë shqiptare, përcaktohen me marrëveshje ndërmjet Agjencisë Kombëtare të Diasporës (AKD) dhe Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL). Për ndjekjen e procesit dhe vlerësimin përfundimtar të dokumenteve të kandidatëve, të cilët do të përfitojnë bursë studimi, institucionin e arsimit të lartë dhe programin e studimit ku do të studiojnë, krijohet Komisioni i Bursave për Diasporën, me urdhër të ministrit përgjegjës për diasporën. Ai përbëhet nga 3 (tre) anëtarë, të cilët do të propozohen nga ministria përgjegjëse për arsimin (1 anëtar), ministria përgjegjëse për politikën e jashtme (1 anëtar) dhe Agjencia Kombëtare e Diasporës (1 anëtar).

8. Agjencia Kombëtare e Diasporës do të kryejë pagesat e mësuesve të nevojshëm për mësimin e gjuhës shqipe në vitin e parë të studimeve për shtetasit e huaj me origjinë shqiptare, të cilët përfitojnë bursa studimi nga Republika e Shqipërisë, për vitin akademik 2020–2021.

9. Financimi i bursave, në zbatim të këtij vendimi, për vitin akademik 2020–2021, ka një vlerë prej 71 520 (shtatëdhjetë e një mijë e pesëqind e njëzet) eurosh. Ky financim do të përballohet nga buxheti i Agjencisë Kombëtare të Diasporës.

10. Ngarkohen ministri i Shtetit për Diasporën dhe Agjencia Kombëtare e Diasporës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

ANEKSI 1

MASA E BURSËS PËR SHTETASIT E HUAJ ME ORIGJINË SHQIPTARE

1.	Studentët me origjinë shqiptare	
	Tarifa e studimit	40000 lekë/vit = 30 euro/muaj
	Akomodimi	300 euro/muaj
	Shpenzimet ushqimore	270 euro/muaj
	Totali mujor i bursës	600 euro/muaj
	Totali vjetor i bursës (9 studentë)	64800 euro

2.	Asistentët për mësimin e gjuhës shqipe	
	Paga mujore	560 euro/muaj
	Paga vjetore (1 asistent)	6720 euro
	Vlera vjetore totale për studentët dhe asistentët	71520 euro